

Akt Thmelimi

I shoqërisë tregtare “ KLESAL ” shpk

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë , të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 , “ Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9723 , datë 03.05.2007 “Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare , me vullnetin e tije të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi:

Ortaku i Vetem Vangjel Prela, me numer personal H60515219K, dtl. 15.05.1976, lindur ne Iballe dhe banues ne Tiranë Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Tefta Tashko”, Nd. 41/9, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar.

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “ KLESAL ” shpk. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqipëtar. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare private “ KLESAL ” shpk do të ketë selinë në adresen: Rruga “Luigj Gurakuqi”, Pallati 4/1, Ap. 9 Njësia Bashkiake Nr. 2, Tirane.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës ss Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve.

Objektivi I Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e :

Ndërtimi dhe projektim i objekteve civile, industriale, rrugë dhe ura. Veprimtari në fushën e ndërtimit si, punime dheu, murature, betoni, betonarme të zakonshme, punime shëmbjesh, ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore, komplementimi me instalimet e nevojshme për to, ujësjellësa, kanalizime, tunele si dhe çdo veprimtari tjetër që do të jetë ne dobi te veprimeve të mësipërme. Tregtim materiale te ndryshme ndertimi, parafabrikateve, eksport-import etj. Ndertimi i banesave shumekateshe, rikonsturksione të rrugeve automobilistike të të gjitha kategorive dhe sinjalistika rrugore, pista dhe aeroporte, punime hekurudhore, punime speciale të shinave e traversave, ndërtim i urave të të gjitha kategorive, ndërtime portuale, ndërtime nëntokësore e themele të veçanta, punime të ndryshme restaurimi, instalim impiantesh teknologjike, pajisje të veçanta ne ndërtesa, punime montimi në impiante dhe linjat e prodhimit dhe shperndarjes së energjetikës, punime shërbimi publike dhe urbane, punime inxhinierike e topogjeodezike. Prodhim e përpunim lendësh të para materiale të ndryshme ndërtimi si rërë, granil, gëlqere, beton, bitum, asfalte, tulla. Veprimtari shitblerje e qiraje të

pasurive të patundshme si troje, banesa, objekte të ndryshme të ndërtimit, linjave makinereive e pajisjeve të ndryshme në fushën e ndërtimit. Import, eksport, tregti me shumicë dhe pakicë e mallrave, sipërmarrje dhe shërbime në fusha të ndryshme.

Shoqeria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.

Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do të jetë me një afat të pakufizuar.. Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkakut .

Kapitali I Shoqerise

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise private “*KLESAL*” shpk do të jetë 100.000 (njëqind mijë leke). Kapitali është i përbërë nga 1 kuotë e barabartë me 100%.

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakesohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi I Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqësuesi ligjor i saj . Ai është përfaqësuesi i Shoqerise në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetencën të plotë në drejtimin e saj .

Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme .

Neni 7

Te ardhurat neto të shoqerise i takojnë ortakëve të shoqerise .

Neni 8

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë .

Neni 9

Shoqeria ka vullnet të saj me madhësi të zakonshme , me logon dhe tekstin brenda saj .

Neni 10

Shoqeria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqerive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt themelimi , rregullohen në Statutin e shoqerise si dhe në legjislacionin përkatës Shqiptar.


Neni 11

Akti I themelimit u perpilua ne 5 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "*KLESAL*" shpk

Akti i themelimit u nenshkrua rregullisht nga ortaket e shoqerise.

Ortaku Vetem i Shoqerise
"KLESAL" SH.P.K.

Vangjel Prela

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Vangjel Prela", with a stylized flourish at the end.